

V E N D I M
Nr.202, datë 16.5.1994

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.138, DATË
31.3.1994 “PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDËVE DJEGËSE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994, në numrin rendor 2 shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“Ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

2. Fondet përkatëse të përballohen nga buxheti i vitit 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 prill 1994, kurse pagesa e kompensimeve fillon pas datës 1 maj 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi